

## KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIT EUROPIAN 2021-2023

### Sesioni 1, Grupi i Punës III (Bujqësia dhe Siguria Ushqimore)

*“Informimi dhe ndërgjegjësimi publik mbi sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit”*

*Roli i institucioneve zbatuese*

**11 maj 2022**

### **Rekomandime**

- Siguria ushqimore është e lidhur ngushtë me mbrojtjen e konsumatorit dhe një nga elementët bazë për të garantuar sigurinë është ofrimi i informacionit ushqimor përmes etiketave. Në gjithë këtë proces, një rol të rëndësishëm luajnë jo vetëm institucionet publike, por edhe operatorët e biznesit, të cilët duhet të garantojnë ofrimin e informacionit ushqimor në të gjithë zinxhirin.
- Procesi i harmonizimit të legjislacionit dhe zbatimi i standardeve dhe kërkesave në kuadër të integrimit europian duhet të kryhet gradualisht dhe duke marrë parasysh nevojat aktorëve që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë nga këto ndryshime. Një shembull nga Sllovakia lidhet me aplikimin e HACCP gjatë integrimit në BE pa bërë dallime ndërmjet operatorëve të biznesit - gjë që çoi në kolaps dhe vështirësi të mëdha për kompanitë e vogla.
- Shkëmbimi i informacionit është thelbësor për kryerjen e detyrimeve në mënyrë efektive. Ky shkëmbim duhet të bëhet në dy plane: 1) ndërmjet institucioneve dhe autoriteteve në nivel lokal dhe kombëtar, 2) shkëmbimi i informacionit dhe përvojave me homologët e shteteve të rajonit dhe të Bashkimit Europian.
- Inspektoriatet duhet të dixhitalizohen duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të institucioneve publike për sigurinë ushqimore dhe standardet e kërkuara për Integrimin Europian.
- Rekomandohet që për të informuar dhe për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve të përfshirë, të cilët preken drejtpërdrejt nga zhvillimet në këtë fushë, institucionet publike përgjegjëse në bashkëpunim me ekspertë kombëtar dhe ndërkombëtarë duhet të zbatohjnë një udhëzues për këta aktorë me informacione për zhvillimet e ligjore, të drejtat, detyrimet, funksionet, kostot etj.
- Siguria ushqimore është një fushë teknike e komplikuar që përfshin shumë

kritere. Sugjerohet që ligji për sigurinë ushqimore të jetë sa më i thjeshtë, ndërkohë që informacioni teknik dhe procedural të detajohet përmes akteve normative dhe rregulloreve.

- Përditësimi dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në këtë fushë do të sjellë ndryshime në kuadrin institucional, rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve ekzistuese dhe atyre që duhet të krijohen. Rekomandohet që roli i çdo institucioni të përcaktohet sa më qartë dhe fokusi të jetë te inspektimi për të garantuar sigurinë ushqimore.
- Për sa i përket burimeve njerëzore, është e rëndësishme të kryhen trajnime të vazhdueshme për inspektorët kryesisht duke ofruar informacion teknik dhe të detajuar vetëm bazuar në përvojën e BE-së ose në përvojën e vendeve anëtare.
- Trajnimi dhe aktivitetet e përbashkëta informuese ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë janë gjithashtu të rëndësishëm. Operatorët e biznesit, prodhuesit por edhe konsumatorët duhet të përfshihen në ato takime për t'u informuar dhe trajnuar për kriteret dhe standardet, por edhe për detyrimet dhe zbatimin që kanë ato rregulla në aktivitetin e tyre të përditshëm.
- Një rol të shtuar në realizimin e këtij bashkëpunimi ndërmjet operatorëve të biznesit dhe institucioneve shtetërore duhet të luajnë dhomat e biznesit, shoqatat e prodhuesve, por edhe shoqëritë konsumatore si një palë të interesuara dhe të prekura drejtpërdrejt nga ky proces.
- Rritja e bashkëpunimit mes sektorit privat dhe ekspertëve e donatorëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është i rëndësishëm. Bashkëpunimi duhet të jetë më i gjerë, më fortë dhe mbi të gjitha më i qëndrueshëm në kohë.